



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:098695

Datë: 07.03.2023

Numri i dokumentit: 04053402

C.nr. 288/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari **Besmir Juniku**, me bashkëpunëtorin profesional Samir Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësve Y. F. dhe Xh. D. që të dy nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike – kompensim nga marrëdhënia e punës, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë **07.03.2023** merr këtë:

A K T V E N D I M

Padia e paditësve Y. F. dhe Xh. D. që të dy nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësit Y. F. dhe Xh. D. që të dy nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, të cilët me autorizim e përfaqëson avokat D. M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike – kompensim nga marrëdhënia e punës.

Gjykata me Aktvendimin C.nr. 288/2022 të datës 24.08.2022, i ka ftuar paditësit që në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh ta paguajnë taksën gjyqësore për padi, me vërejtje se në rast se të njëjtën nuk e paguajnë do të konsiderohet se e kanë tërhequr padinë.

Në shkresat e lëndës ekziston prova – fletëkthesa se i autorizuari i paditësve me datën 02.09.2022, e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, ndërsa nuk e ka bërë pagesën e taksës së kërkuar për padinë.

Sipas nenit 253 parg. 5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore Nr. 03/L-006 (LPK) është paraparë se “*në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas*

vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.”

Duke marr parasysh faktin se as pas aktvendimit të dërguar nga gjykata, paditësit nuk e kanë bërë pagesën e taksës për padi brenda afatit të përcaktuar, ndërsa nuk ekzistojnë kushtet për lirim të tij nga pagesa e të njëjtës, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi konform nenit 253 parag. 5 lidhur me nenin 387 parg. 1 pika c) të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr. 288/2022, me datë 07.03.2023.**

**Bashkëpunëtor profesional
Samir Morina**

**GJYQTARI
Besmir Juniku**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, për Gjykatën e Apelit, nëpërmjet kësaj gjykate.